

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
السلام عليكم ورحمة الله وبركاته

FJALA E RASTIT PËR HIXHRETIN

(Pallati i Kulturës, Shkup. E organizuar nga Forumi Rinor Islam.
Vitit 2006)

“Nëse ju nuk i ndihmoni atij (Pejgamberit), All-llahu i ka ndihmuar, kur e dëbuan mohuesit atë vetë të dytin, kur këta të dy ishin në shpellë, e kur i tha shokut të vet: “Mos u mërzit! Se, Perendia, me të vërtetë është me ne!” E, perendia, e zbriti qetësinë mbi shokun e tij, kurse ate e ndihmoi me ushtrinë, të cilën ju uk e ken parë. Dhe, bëri që fjala e mohuesve të jetë e poshtër, kurse fjala e Perendisë të mbetet lartë. Me të vërtetë, Perendia, është i Plotfuqishëm dhe i Gjithdijshëm.” (Tevbe, 40)

Të nderuar të pranishëm,

Besimtarë të dashur,

Sonte në këtë natë të bukur jemi tubuar të festojmë dhe njëherit të përkujtojmë Hixhretin e Pejgamberit a.s. nga Mekkeja në Jethrib – Medine. Ky përkujtim është ngusht i ndërlidhur me fillimin e çdo vitit të ri hixhri – muslimanë. Po, hixhreti i Pejgamberit a.s. në historinë njerëzore shënoi një faqe të re. Në fakt me hixhretin e muslimanëve prej Mekkës në Medine në historinë e njerëzimit filloi një jetë krejtësisht e re: e re në kuptim të rendit shoqëror të cilin u përpoqën ta ndryshojnë të gjithë pejgamberët e mëparshëm, një jetë e re ndërnjerëzore dhe ndërmuslimane, një jetë e re politike pra edhe ushtarake e strategjike.

Muslimanët nga hixhreti gjithmonë mësojnë atë që e harrojnë. Harrojnë sepse njeriu është qenie e cila shpeshherë me dëshirë për kah e mbara veten e hudhë në greminën e pafund. Pra hixhreti na përkujton beslidhjen e emigrantëve me vendasit/ muhaxhirëve me ensarët, na përkujton pajtesën e armiqtësisë shekullore që kishin dy fiset e Jethribit Evs dhe Hazrexh, na kujton drejtësinë të cilën e vendosi Vethikeja – Kushtetuta e parë e shkruar nga Pejgamberi a.s.,

na përkujton, mos dhasht Zoti, se jemi larguar nga mësimet e Pejgamberit a.s. nga mësimet Islame.

Ky manifestim i sontshëm, i organizuar nga Forumi Rinor Islam, dëshmon se Islami nuk është fe i botës tjetër, përkundrazi është fe e kësaj bote, Islami është fe e vëllazërisë dhe unitetit, nuk është fe e armiqësisë dhe e shkatërrimit, Islami nuk është fe militante, por është fe e paqes, Islami nuk është fe e urrejtjes; Islami është fe e dashurisë, se Islami nuk është fe vetëm e pleqëve përkundrazi Islami është fe e rinisë, po e rinisë sepse ata janë ardhmëria e jonë, ata janë ardhmëria e botës.

Në ndërkohë le të kuptojmë se ka ardhur koha që përfundimisht të kuptojmë se manifestimet fetare, të quajtura në fjalorin ateist, janë manifestime të njeriut sepse njeriu sa do që të jetë qenie shoqërore aq është edhe qenie fetare. Ky manifestim le të jetë një dëshmi se edhe shqiptarët edhe muslimanët dinë të organizojnë jetën e tyre fetare e kulturore, por këtë duhet para së gjithash t'ua mundësojë elita politike dhe shtetërore sepse deshtëm ose jo, ne si do që të na trajtojë dikush, jemi pjesë e pandarë e kësaj shoqërie. Pra të mos harrojmë se edhe ne japim kontributet tona kësaj shoqërie e cila dita më ditë nuk dinë ose nuk donë që vlerave t'ju jap vendin e merituar. Dhe së fundi këto manifestime kulturore e fetare le të dëshmojnë fuqishëm para opinionit se mësimi i vlerave fetare vetëm e fisnikëron të riun e nuk e dëmton, mësimi i këtyre vlerave na bashkon secilin në fenë dhe në kulturën tonë, pra kjo le të jetë një selam i fortë qeveritarëve se inkuadrimi i lëndës fetare në shkollimin publik do të jetë ardhmëria dhe mirësia e qytetarëve të vendit ku jetojmë.

O All-llah, o Zoti im i dashur, të lus që për hirë të të dërguarëve tu e në veçanti të Dërguarit të fundit, për hir të Madhërisë Tënde dhe për hir të kësaj ndodhie të madhe historike na përforco në rrugën e Islamit, na largo nga të këqijat e dukshme dhe të padukshme të kësaj bote, na bën prej robërve Tu të devotshëm e të vyeshëm për familjet tona, për shoqërinë tonë dhe mjedisin ku jetojmë. Përforco rininë tonë në Islam, mundësoju që të kultivojnë vlerat e larta fetare e njerëzore, largoji nga të këqijat e të gjitha llojeve. Amin.